



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit 04/L-095 për diasporën dhe mërgatën, nenit 11 par.11.3 të Strategjisë për diasporën dhe mërgatën 2013-2018 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT NDËRLIDHËS PËR DIASPORËN NË KOMUNËN E
LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, caktohet **Burim Gashi**, shef i sektorit për Administratë, Zyrtar ndërlidhës për diasporën në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Shërbyesi civil i caktuar në nenin 1 të këtij Vendimi, do ti kryej punët dhe detyrat në pajtim me dispozitat e Ligjit për diasporën dhe mërgatën, Strategjisë për diasporën dhe mërgatën 2013-2018, Planit të Veprimit të kësaj strategjije si dhe udhëzimeve e trajnimeve të organizuara nga Ministria e Diasporës në bashkëpunim me organet e tjera.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet do të njoftohet Ministria e Diasporës, Drejtorati për Administratë dhe Burim Gashi.

1Nr. 112 - 22013

Lipjan, më 27.04.2016

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

